

# NEWSLETTER: NËNTOR 2025

## Më Shumë Integritet, Më Pak Korrupsion: ACER dhe AIS Promojnë Metodologjinë e Vlerësimit Parandalues për Korrupsion

Ky publikim zhvillohet në kuadër të projektit "Parlamenti dhe përfaqësuesit politikë angazhohen me organizatat e shoqërisë civile për të nxitur llogaridhënien dhe transparencën" zbatuar nga **Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)** dhe **Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)**. Iniciativa mbështetet nga **Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD)** në kuadër të projektit "Korniza e Ballkanit Perëndimor: Investim në Qëndrueshmërinë Demokratike", financuar nga FCDO përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë. Projekti synon të forcojë rolin e advokimit dhe monitorimit në lidhje me Kuvendin e Shqipërisë, si dhe të zhvillojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të kuptuar dhe përdorur Metodologjinë e Vlerësimit Parandalues për Korrupsion.

**Vlerësimi Parandalues për Korrupsion (CPL)** është një metodologji e miratuar dhe tashmë e përdorur nga **Kuvendi i Shqipërisë** për të analizuar projektligjet dhe për të identifikuar rreziqet potenciale të korrupsionit. Ajo siguron që ligjet të jenë transparente, të drejta dhe të zbatueshme pa hapësira për abuzim, duke forcuar integritetin publik dhe duke nxitur më shumë llogaridhënie e transparencë në procesin ligjvënës.

## RRITJA E KAPACITETEVE

Si pjesë e këtij projekti, ACER dhe AIS kanë orgnizuar **dy trajnime** për t'i pajisur organizatat e shoqërisë civile (OSHC) me aftësitë për të zbatuar në mënyrë të pavarur Metodologjinë për Vlerësimin Parandalues për Korrupsion të miratuar dhe zbatuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

### Trajnimi nr.1



Në trajnimin e parë, partnerët nga OSHC-të u njohën me sfidat e kuadrit ligjor, rreziqet e korrupsionit në proceset legjislativë dhe dimensionin ekonomik të tij, përmes qasjes analitike të ACER. Ekspertët e ACER dhe AIS prezantuan **hapat, strategjitë dhe shembuj praktikë** për hartimin e një vlerësimi efektiv.

#### Organizatat përfituese:

1. Qendra ALTRI
2. Instituti për Zhvillim Strategjik
3. Together for Life
4. Faktoje.al
5. BIRN
6. Drejtësia Sociale
7. Center for Legal Empowerment (CLE)
8. Citizen Channel

[Lexo më shumë](#)

## Trajnimi nr.2



Trajnimi i dytë kishte si synim të ishte më i targetuar, duke u fokusuar në prezantimin nga dy ekspertë të Metodologjisë së Vlerësimit Parandalues për Korrupsion me **shembuj konkretë nga vlerësimet e mëparshme**.

### Organizatat përfituese

1. Qendra ALTRI
2. IANS
3. Together for Life
4. BIRN Albania
5. ISDC
6. IRCA
7. Citizens Channel

“ Ky diskutim tregoi se angazhimi i të gjitha palëve është kyç për të siguruar që projektligji t'i shërbejë interesit publik dhe jo interesave private ”

Përfaqësues i një organizate me fokus aktivizmin qytetar

[Lexo më shumë](#)



## Dialog Profesional me Eksperten Ndërkombëtare të 'Vlerësimit Parandalues për Korrupsion' për Përmirësimin e Legjislacionit

Në këtë takim, ku morën pjesë **Qendra ALTRI, Drejtësi Sociale, CLE, Together for Life dhe Citizens.al**, diskutimi u udhëhoq nga ekspertja ndërkombëtare **Cristina Ciubotaru** dhe **Viktor Gumi** nga AIS. Ata prezantuan mënyrën e zbatimit të Metodologjisë së Vlerësimit Parandalues për Korrupsion, duke sjellë shembuj konkretë dhe analizuar një projektligj aktual. Takimi theksoi rolin kyç të OSHC-ve në identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies gjatë procesit ligjvënës.

[Lexo më shumë](#)

## PERGATITJA E ANALIZAVE CPL

### Vlerësimin Parandalues për Korrupsion të Projektligjit për Mbetjet

Në kuadër të CPL-së së parë u përzgjedh projektligji “Për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Subjekteve Prodhuese të Produkteve që Gjenerojnë Mbetje”, pasi ligji prek drejtpërdrejt interesin publik dhe përmban elementë kyç të transparencës, konsultimit dhe harmonizimit me standardet e BE.

#### Gjetjet kryesore nga CPL:

- **Transparenca dhe konsultimi publik:** Nga 2,317 shikime, u dhanë vetëm 4 komente. Bashkitë nuk u konsultuan, dhe mungesa e shqyrtimit në Këshillin Konsultativ paraqet një mangësi procedurale.
- **Qëllimet e ligjit:** Synon parimin “ndotësi paguan”, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, në përputhje me Direktivën e BE dhe Kapitullin 27.
- **Interesat publike dhe private:** Interesi publik synon menaxhim më të mirë dhe ulje kostosh, por ka rrezik konflikti interesi të shoqëritë e prodhuesve dhe mospërputhje me RIA-n.
- **Përshtatshmëria:** Ligji është i nevojshëm, pasi nuk ka ekzistuar më parë një legjislacion i tillë.
- **Implikimet financiare:** Ligji nuk jep një vlerësim të qartë financiar. Përrjashtimi i taksave për plastikën nuk mbështetet me të dhëna të sakta, por në afat të gjatë mund të ulë kostot publike dhe të nxisë riciklimin.

## ADVOKIMI



Tryeza e diskutimit për vlerësimin e projektligjit mbi mbetjet u zhvillua më 29 tetor me **33 pjesëmarrës**, përfshirë

- **7 deputetë**
- **3 organizata të medias**
- **2 organizata të sektorit privat**
- **7 organizata të aktivizmit dhe të drejtave të njeriut dhe**
- **6 organizata në fushën e sundimit të ligjit.** Deputetët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kontribuan aktivisht, duke diskutuar gjetjet e opinionit dhe duke theksuar nevojën për reflektimin e mangësive të projektligjit, për të siguruar një proces ligjvënës më transparent dhe efektiv.

Opinioni i përgatitur u shpërnda te **140 deputetë**, dhe seanca dëgjimore u zhvillua më 3 nëntor në **Komisionin për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm**, ku ekspertët nga **WFD, ACER** dhe **AIS** prezantuan dhe mbrojtën gjetjet e tyre. **Projektligji u kthye në Parlament për përmirësim.**

“ Diskutimi na dha një mundësi unike për të lidhur analizën profesionale me nevojat praktike të qytetarëve dhe komunitetit. ”

*Përfaqësues i sektorit privat*

[Lexo më shumë](#)

## TË FUNDIT

Kërkime dhe analiza të politikave nga ACER dhe AIS për forcimin e integritetit dhe qeverisjes në Shqipëri.

### ACER

ACER, themeluar në vitin 1992, është një nga organizatat më të hershme të pavarura në Shqipëri, e fokusuar në kërkime ekonomike, qeverisje dhe luftën kundër korrupsionit. ACER realizon studime, analiza politike dhe aktivitete advokuese për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe integritetin institucional, duke angazhuar qytetarët, bizneset dhe institucionet publike në një dialog të bazuar në evidenca.



### AIS

AIS, i themeluar në vitin 2011, është një organizatë e shoqërisë civile e dedikuar promovimit të transparencës, qeverisjes së mirë dhe të dhënave të hapura në Shqipëri. AIS zhvillon platforma digjitale, kryen kërkime dhe monitoron prokurimet publike, zgjedhjet dhe shpenzimet qeveritare, me qëllim luftimin e korrupsionit dhe fuqizimin e qytetarëve me informacion të aksesueshëm dhe të bazuar në evidenca.



Mendimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të WFD ose të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar.

